



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:032179

Datë: 01.09.2021

Numri i dokumentit: 02134755

**C.nr.1012/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtaren Mihane Ismajli, në çështjen juridike kontestuese të paditësve: F. M., F. F., A.B., E.S. dhe A.M., që të gjithë nga Prishtina, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit, A.M., av. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë, rruga UÇK-së, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Vjollca Raniqi Morina, zyrtare ligjore të e paditura, për kompensimin e pagave për shpërblim jubilar dhe pagesën për shujta, vlera e kontestit 9,975.75€ në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 07.07.2021, në prani të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** në tersi e bazuar Kërkesëpadia e paditësve : F. M., F. F., A.B., E. S. dhe A.M., që të gjithë nga Prishtina,

**I.DETYROHET** e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë, që paditësve edhe atë:

- 1) F. M., nga Prishtina, në emër të shpërblimit jubilar për 16 vite të përvojës së punës, në vlerë prej 50% të një page baze t'ia kompensojë shumën prej 210.00 € si dhe në emër të ushqimit-shujtave gjatë ditëve të punës (shujtave ditore) për (903 ditë) pune, duke llogaritur prej datës 18.04.2017 deri me datën 04.03.2021 nga 2 € për secilën ditë të prezencës në punë, t'ia kompensojë shumën në lartësi 1,806.00 €, pra gjithsej shumën e përgjithshme prej 2,016.00 €,
- 2) F. F., nga Prishtina, në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës, në vlerë prej 75% të një page baze t'ia kompensojë shumën prej 315.75 € në emër të ushqimit-shujtave gjatë ditëve të punës (shujtave ditore) për (903 ditë) pune, nga 2 euro për secilën ditë të prezencës në punë prej dt.18.04.2017 deri me dt.04.03.2021 t'ia kompensoj shumën prej 1,806.00 €, gjithsejtë shumën 2,121.75,
- 3) A.B. nga Prishtina, në emër të shpërblimit jubilar për 19 vite përvojës së punës në vlerë prej 50% të një page bazë, t'ia kompensojë shumën prej 210.00 € si dhe në emër të kompensimit për

ushqim gjatë punës (shujtave ditore) për(903 ditë) pune, nga 2 euro për secilën ditë të prezencës në punë prej dt.18.04.2017 deri me dt. 04.03.2021 t'ia kompensoje shumën prej 1,806.00 €, në shumën e përgjithshme 2,016.00 €,

4, E. S. nga Prishtina, në emër të shpërblimit jubilarë për 15 vite përvojës së punës në vlerë prej 50% të një page bazë, t'ia kompensojë shumën prej 210.00 €, në emër të ushqimit-shujtave gjatë ditëve të punës (shujtave ditore) për (903 ditë) pune, nga 2 euro për secilën ditë të prezencës në punë prej dt.18.04.2017 deri me dt.04.03.2021 t'ia kompensoj shumën prej 1,806.00 €, gjithsejtë 2,016.00 €,

5) A.M. nga Prishtina, në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës (shujtave ditore) për (903 ditë) pune, nga 2 € për secilën ditë të prezencës në punë prej dt.18.04.2017 deri me dt.04.03.2021 t'ia kompensoje shumën prej 1,806.00 €, të gjitha këto kërkesa me kamatë ligjore prej 8%, nga data e ushtrimit të padisë në gjykatë (02.03.2020) e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

**ILDETYROHET** e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë, që paditësve t'ua paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 778.00 € (shtatëqind/e/shtatëdhjetë/e/tetë/euro/e/zero/cent).

### **A r s y e t i m**

Paditësit përmes të autorizuarës të tyre në këtë gjykatë me datë (02.03.2020) , kanë ushtruar padi kundër të paditurës, të cilën e kanë precizuar në seancën me parashtresën e datës 06.07.2021, ku çështjen e kanë paraqitur si në vijim:

Paditësit janë të punësuar te e paditura , si mësimdhënës në shkollën fillore SHFMU “ N. F. ” në Prishtinë. Duke marr parasysh kohën e nënshkrimit të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës të datës 18.04.2017, përkatësisht nenit 35 paragrafi 7 dhe paragrafit 8 dhe të drejtave të cilat i njihen me kontratë punëtorëve të arsimit, ndër të tjera të drejtën e kompensimit për ushqim gjatë punës, të cilën të drejtë e përcakton neni 35, paragrafi 7, i cili parasheh që: “të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një dite pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...”, e cila e drejtë nuk iu është njohur punëtorëve të arsimit, prej ditës së nënshkrimit-hyrjes në fuqi të kësaj kontrate me datë 18.04.2017. Po ashtu sipas kontratës së lartcekur konkretisht nenit 35 paragrafi 8 punëtorëve të arsimit ju takon edhe shpërblimi jubilar, e cila sipas nenit 8.6 duhet të paguhet me rastin e 7 Marsit të çdo viti, andaj e autorizuara e paditëseve në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë si dhe precizimit të saj , duke kërkuar që gjykata që të njëjtën të aprovoj në tersi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas TA të OAK-së.

E paditura përmes përfaqësueses së saj të autorizuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, e kundërshtojë në tersi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar, meqenëse një kompensim i tillë nuk është paraparë me Ligjin e Punës. Pastaj e paditura në skemën e saj buxhetore nuk ka paraparë linjë të veçantë për këtë lloj kompensimi, andaj mbi bazën e këtyre fakteve i propozoj gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tersi të pa bazuar.

Për të vlerësuar drejtë dhe për të vërtetuar gjendjen faktike lidhur me çështjen juridike konkrete në shqyrtimin kryesor - publik, me propozimin e të autorizuarit të paditësve gjykata bëri administrimin e provave dhe atë:

Për paditësen F. M. Lexohen dhe shikohen: kontrata e punës te paditurës Komunës se Prishtinës me nr. te protokollit 151/11 dt: 01.09.2011, vërtetimi i SHFMU“ Pjetër Bogdani “ ne Prishtine nr. i protokollit 36/20 dt. 22.01.2020 , vërtetimi SHFMU “ Naim Frashëri” në Prishtinë me nr të prot. 1116/2020 n , datë 23.01.2020 për përvojë të punës, vërtetimi SHFMU“ Naim Frashëri ” në Prishtine nr. i protokollit 105/21 dt. 06.07.2021 për ditët e vijimit në punës dhe lista e pagave e të paditurës së datës 30.04.2021.

Për paditësin, F. F. lexohen dhe shikohen: kontrata e punës te paditurës Komunës se Prishtinës me nr. te protokollit 53/21 e dt. 11.03.2016, vërtetimi SHFMU “ Naim Frashëri “ në Prishtinë, nr. i protokollit 1118/20 dt. 23.01.2020 për përvojë të punë, vërtetimi SHFML“ Naim Frashëri “ në Prishtinë nr. i protokollit 102/2021 dt. 06.07.2021 për ditët e vijimit në punë dhe lista e pagave e të paditurës së datës 30.04.2021.

Për paditësen A. B. lexohen dhe shikohen: kontrata e punës te paditurës Komunës se Prishtinës me nr. te protokollit 04/ 149 e dt: 11.03.2016, Lexohen dhe shikohet vërtetimi SHFMU “Naim Frashëri “ ne Prishtinë nr. i protokollit 101/21 dt. 06.07.2021 për ditët e vijimit në punë, vërtetimi SHFMU“ Naim Frashëri” në Prishtinë nr. i protokollit 101/2021 dt. 06.07.2021 për përvojën e punës, dhe lista e pagave e të paditurës së datës 30.04.2021,

Për paditësen E. S. ,lexohen dhe shikohen: kontrata e punës te paditurës Komunës se Prishtinës me nr. të protokollit 59/181 dt: 11.03.2016, vërtetimi SHFMU “Naim Frashëri” në Prishtinë, nr. i protokollit 104/21 dt. 06.07.2021 për ditët e vijimit në punë, vërtetimi SHFMU “Naim Frashëri” në Prishtinë nr. i protokollit 73/20 dt. 1114/2020 për përvojën e punës dhe lista e pagave e të paditurës së datës 30.04.2021,

Për paditësen A.M. lexohen dhe shikohen: kontrata e punës te paditurës Komunës se Prishtinës me nr. te protokollit 2014 e dt: 12.09.2018, vërtetimi SHFMU “Naim Frashëri” në Prishtine nr. i protokollit 103/2021 dt. 06.07.2021 për ditët e vijimin në punë, vërtetimi SHFMU“ Naim Frashri” në Prishtinë nr. i protokollit 103/21 dt. 06.07.2021 për përvojën e punës dhe lista e pagave e të paditurës së datës 30.01.2021, me rastin e vendosjes gjykata pati parasysh edhe deklaratimet e të autorizuarit të palëve paditëse të bëra gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën e tij përfundimtare.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Paditësit duke konsideruar se iu takon e drejta në kompensimin e pagave në emër të shpërblimit jubilar dhe kompensimi i shujtave të ushqimit, pasi që e paditura nuk e ka bërë pagesën e tyre i janë drejtuar gjykatës me padi.

Nga provat e administruara si më lartë gjykata gjeti se kërkesëpaditë e paditësve janë te drejta dhe të bazuara në ligj sepse gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua fakti se:

Paditësja F. M. , është duke punuar te e paditura të njëjtit nuk i është kompensuar paga në emër të shpërblimit jubilar për 16 vite të përvojës së punës, në vlerë prej 50% të një page baze në shumen prej 210.00 € si dhe nuk i është kompensuar në emër të ushqimit-shujtave gjatë ditëve të punës (shujtave ditore) për (903 ditë) pune, duke llogaritur prej datës 18.04.2017 deri me datën 04.03.2021 nga 2 € për secilën ditë të prezencës në punë, në lartësi prej 1,806.00 €,

Paditësit F. F., nga Prishtina , është duke punuar te e paditura të njëjtit nuk i është kompensuar në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës, në vlerë prej 75% të një page baze në shumen prej 315.75 € si dhe nuk i është kompensuar në emër të ushqimit-shujtave gjatë ditëve të punës (shujtave ditore) për (903 ditë) pune, nga 2 euro për secilën ditë të prezencës në punë prej dt.18.04.2017 deri me dt.04.03.2021 në shumë prej 1,806.00 €,

Paditësja A.B. është duke punuar te e paditura të njëjtës nuk i është kompensuar në emër të shpërblimit jubilar për 19 vite përvojës së punës në vlerë prej 50% të një page bazë, shumën prej 210.00 € si dhe në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës (shujtave ditore) për(903 ditë) pune, nga 2 euro për secilën ditë të prezencës në punë prej dt.18.04.2017 deri me dt. 04.03.2021 në shumë prej 1,806.00 €,

Paditësja E. S., është duke punuar te e paditura, të njëjtit nuk i është kompensuar paga në emër në emër të shpërblimit jubilar për 15 vite përvojës së punës ne vlere prej 50% të një page bazë, në shumën prej 210.00 €, si dhe në emër të ushqimit-shujtave gjatë ditëve të të punës (shujtave ditore) për (903 ditë) pune, nga 2 euro për secilën ditë të prezencës në punë prej dt.18.04.2017 deri me dt.04.03.2021 në shumën prej 1,806.00 €,

Paditësja A.M. , është duke punuar te e paditura, të njëjtit nuk i është kompensuar, në emër të ushqimit gjatë punës (shujtave ditore) për (903 ditë) pune, nga 2 € për secilën ditë të prezencës në punë prej dt.18.04.2017 deri me dt.04.03.2021 në shumen prej 1,806.00 €, ngase bazuar në nenin 35 par.8 të kësaj Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, e cila ka hyrë në fuqi nga data 18.04.2017, është paraparë pagesa jubilarë dhe në kohën kur paditësit kanë fituar kushtin për kompensimin e pagave jubilarë, Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, ka qenë në fuqi.

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson, se e paditura ka pasur detyrim që paditësve t`ua paguaj pagën jubilarë ashtu siç është cekur me lartë , ngase për të njëjtit gjykata vërtetoi faktin nga shkresat elaboruara me lartë se te njëjtit kanë përvojë pune ashtu siç është cekur ne

në dispozitiv të aktgjykimit, e që ky fakt është vërtetuar nga vërtetimet e përvojës së punës të cekura më lartë, andaj ka gjetur se kërkesëpaditë e paditësve janë të bazuara dhe i ka aprovuar atë, në shumën e gjykuar si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjeti se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, e cila ka hyrë në fuqi nga data 18.04.2017, dhe e njëjta është e zbatueshme, ndërsa në nenin 35 par.7 të kësaj marrëveshje është paraparë pagesa e shujtës së ushqimit për punëtorët, për ditët të cilat janë në punë, në lartësi prej 2 €, me përjashtim në rast se e paditura e ka të rregulluar këtë çështje përmes restaurantit apo kuzhinës ose në një fomë tjetër, andaj gjykata bazuar në nenin e lartcekur si dhe nga shkresat e lëndës nuk ka ndonjë provë me të cilën do të vërtetohej se e paditura e ka rregulluar në ndonjë formë tjetër këtë çështje qoftë përmes restorantit apo kuzhinës apo ndonjë formë tjetër, gjeti që paditësve në këtë rast u takon e drejta e kompensimit në emër të shujtës për ushqim, në shumë prej 2 euro për çdo ditë të qëndrimit në punë.

Lartësinë e kërkesë të paditësit F. M., gjykata e vërtetoi në bazë të vërtetit të ditëve të punës të SHFMU “ Naim Frashëri ” në Prishtinë me nr. të prot. i protokollit 105/21 dt. 06.07.2021 për ditët e vijimit në punës me të cilin vërtetohet se paditësja ka mbajtur 903 ditë) pune, duke llogaritur prej datës 18.04.2017 deri me datën 04.03.2021 nga 2 € për secilën ditë të prezencës në punë, në lartësi prej 1,806.00 €,

Lartësinë e kërkesë të paditësit F. F., gjykata e vërtetoi në bazë të vërtetimit të ditëve të punës të SHFMU “ Naim Frashëri” në Prishtinë me nr. të prot. 102/2021 dt. 06.07.2021 për ditët e vijimit në punë ,me të cilin vërtetohet se paditësi ka mbajtur (903 ditë) pune, nga 2 euro për secilën ditë të prezencës në punë prej dt.18.04.2017 deri me dt.04.03.2021, në shumën prej 1,806.00 €,

Lartësinë e kërkesë të paditëses A. B., gjykata e vërtetoi në bazë të vërtetimit të ditëve të punës të SHFMU “Naim Frashëri” në Prishtinë me nr. të prot. protokollit 101/21 dt. 06.07.2021 nga i cilët vërtetohet se paditësja ka mbajtur (903 ditë) pune, nga 2 euro për secilën ditë të prezencës në punë prej dt.18.04.2017 deri me dt. 04.03.2021, në shumë prej 1,806.00 €,

Lartësinë e kërkesë të paditëses E. S., gjykata e vërtetoi në bazë të vërtetimit të ditëve të punës të SHFMU “ Naim Frashëri ” në Prishtinë me nr. të prot. 101/21 dt.

06.07.2021 nga i cili vërtetohet se paditësja ka mbajtur për (903 ditë) pune, nga 2 euro për secilën ditë të prezencës në punë prej dt.18.04.2017 deri me dt.04.03.2021, në shumë prej 1,806.00 €,

Lartësinë e kërkesë të paditëses A.M. gjykata e vërtetoi në bazë të vërtetimit të ditëve të punës të SHFMU “ Naim Frashëri ” në Prishtinë me nr. të prot. 103/2021 dt. 06.07.2021 i cili vërtetohet se paditësja ka mbajtur për (903 ditë) pune, nga 2 euro për secilën ditë të prezencës në punë prej dt.18.04.2017 deri me dt.04.03.2021, në shumë prej 1,806.00 €,

Ndërsa lartësinë e pagave të paditësve gjykata e ka vërtetuar në bazë të listave të pagave të paditurës të datës 30.04.2021, e paditura duke mos e kryer detyrimin e saj, rezulton se u ka mbetur borxh paditësve për pagesën pagave jubilarë dhe shujtave për ushqim ashtu siç është cekur më lartë, andaj ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësit e

kanë cilësinë e kreditorit, ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, bazuar nën nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së) parashihet se “*kreditori në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij*”, prandaj, gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura u ka mbetur borxh paditëseve me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve t’ua kompensoj borxhin në shumat e gjykuara.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8 %, i referohet nenit 382 par. 1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr.04/L-077 dhe si moment të fillimit të kamatës gjykata ka marr datën e ushtrimit të padisë në gjykatë,( 16.12.2020).

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 449, 452 dhe 463, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, dhe Tarifës së OAK-së, nr. 6 dhe 7edhe arë : për padi shumë 312.00 € ( pesë paditës sipas vlerës së kërkesë padisë deri në 10.000.00 €), për seanca shumë 405.60 (pesë paditës sipas vlerës së kërkesë padisë deri në 10.000.00 €), si dhe për taksë gjyqësore shumë prej 60.00 €, GJITHSEJTË shumë prej 778.00 €.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. 1012/2020, datë 07.07.2021

#### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Gj y q t a r j a  
Mihane Ismajli

#### U RDHROHËN:

Paditësit që të paguajnë taksën gjyqësore në shumë prej 60.00 e , në afat prej 3/tri ditësh.